

## Wat is het coronavirus? | 14/04/2020

### ALBANEES | Vertaald uit het Nederlands

#### Koronavirusi

Koronavirusi është një virus i ri dhe shumë ngjitës. Është e lehtë ta marrësh nga njerëzit e tjerë dhe t'ia transmetosh të tjerëve.

### Pse duhet që gjithësecili të rrijë në shtëpi sa më shumë të jetë e mundur?

- Nëse ne të gjithë rrijmë brenda, atëherë virusi shpërndahet më ngadalë.
- Nëse ne nuk sëmurim, atëherë më pak njerëz duhet të shkojnë në spital. Kështu, ne i mbrojmë personat që sëmurën lehtësisht. Pra në këtë rast mjekët dhe infermierët e kanë më pak të vështirë.

### Cilat janë simptomat?

Simptomat më të rëndësishme janë

- temperaturë, kollitje dhe probleme me frymëmarrjen.
- ndonjëherë hundë të zëna (të bllokuara), dhimbje fyti dhe diarre.

Ke një nga këto simptoma? Telefono mjekun e familjes!

Disa njerëz e kanë virusin por nuk kanë simptoma. Pra, është shumë e rëndësishme që të rrespektohen rregullat dhe sa më tepër të jetë e mundur të rrihet në shtëpi!

### Si përhapet virusi?

Kur kollitesh apo teshtin, pikëza të vogla fluturojnë në ajër. Kështu mund të përhapet virusi dhe mund të bie mbi sende/gjëra. Pikëzat fluturojnë mesatarisht deri një metër larg.

Si infektohesh? Nëse i thith këto pikëza duke marrë frymë ose duke i futur duart në gojë, në hundë apo në sy.

Çfarë duhet të bësh?

- Mbaj distancë prej 1,5 metrash nga personat e tjerë!
- Laji shpesh duart! Bëje atë se s'bën/pa dyshim, nëse prek sendet/gjërat që shumë persona të tjerë i kanë prekur! Për shembull: një dorezë të derës apo një buton të ashensorit.

### A ka një vaksinë ose trajtim kundër virusit?

Askush nuk ka antitropa për të qenë imun për virusin. Për momentin nuk ka as vaksinë. Mjekët dhe shkencëtarët po e studiojnë virusin në këtë moment. Ata analizojnë çdo person të sëmurë dhe çdo ditë mësojnë gjëra të reja për këtë. Kështu, ata mund të gjejnë një trajtim të mirë.

Je i sëmurë dhe nuk je në spital? Në këtë rast, paracetamoli është ilaçi më i mirë kundër temperaturës dhe dhimbjes.

Disa organizata kriminale shesin ilaçe të falsifikuar ose ilegalë me përbërje klorokine. Nuk ka absolutisht asnjë garanci, që këta ilaçe japin efekte të mirë apo janë të sigurtë. Biles/Madje ata mund të jenë shumë të dëmshëm për shëndetin tënd.

### Si mund t'a mbrosh vetveten?

- Laji duart me ujë dhe sapun!
- Mbaj 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
- Mos e prek fytyrën tënde!